

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Nuk ka si të mos jem dakord më ato që tha zoti Shehi. Një diskutim i tillë duhet të ishte bërë ditën me diell, që në mëngjes, dhe të kishte pasur vëmendjen e të gjithë qytetarëve, e të gjithëve ju. Sidoqoftë, deputetët e Partisë Demokratike, për respektin tuaj, qëndruan në sallë gjatë gjithë kohës, debatuan dhe paraqitën pikëpamjet e tyre për programin e qeverisë dhe të Kryeministrit. Nuk e di sa keni pasur mundësi të lexoni apo ta dëgjoni programin, por nëse do ta kishit bërë, do të kuptonit ose do të mendonit se jetojmë në një vend që është aq mirë, sa asgjë nuk ka nevojë për t'u përmirësuar. Në fakt, ne e dimë se, pavarësisht se çfarë thotë Kryeministri, pavarësisht çfarë thotë qeveria, edhe ju e dini mirë se e vërteta është krejt ndryshe; e dini mirë se Shqipëria reale nuk ngjan fare me Shqipërinë imagjinare që përpiqet të ekspozojë Edi Rama. Qytetarët nuk kanë nevojë të shkojnë larg për ta kuptuar këtë, sepse mjafton të shikojnë ekonominë familjare, faturat e rritura të energjisë dhe ujit, faturat e rritura të gazit dhe çmimet e larta të ushqimeve; të shikojnë pagat e ulëta, taksat e larta, ujin, që mungon në shtëpi, energjinë, që ndërpritet; të shikojnë pamundësinë për të çuar fëmijët në shkollë për t'u edukuar, apo prindërit në spital për t'u kuruar; të shikojnë me dhimbje të madhe kur fëmijët e tyre të papunë, të pashpresë, megjithëse të mirëarsimuar, largohen me ndershmëri nga vendi.

Në këto kushte ne kemi detyrimin ligjor dhe moral t'u flasim qytetarëve shqiptarë, që nuk njohin njeri në qeveri dhe për rrjedhojë, nuk zgjidhin dot asnjë hall, që nuk njohin njeri në qeveri dhe nuk gjejnë punë për fëmijët e tyre, qytetarëve që e kanë të vështirë të pranojnë se, pasi robtohen gjithë muajin në punë, nuk kanë mundësi të paguajnë faturat. Për fat të keq, këta janë shumica! Nga ana tjetër, programi që Kryeministri prezantoi sot është një listë premtimesh që, në gjykimin tim, është i pavlerë edhe për të. Si dokument, është kaq i pavlerë edhe për të, sa nuk e ka vuar mendjen, të paktën, të rakordonte shifrat. Ne kemi një dokument të firmosur nga Edi Rama, ku thuhet se borxhi publik në vitin 2024 do të jetë 74%, por kemi edhe një dokument të firmosur nga Edi Rama, ku thuhet se borxhi publik do të jetë nën 60% në të njëjtin vit; kemi një dokument të firmosur nga Edi Rama, ku thuhet se do të rriten pensionet me rreth 2%, dhe kemi një dokument të firmosur ku thuhet se do të rriten me 5%. Pra, nuk kujdeset më as për këto, sepse me një plan tjetër është mësuar, dha në kokë ka një plan tjetër: më mirë të blejë vota, sesa të punojë për t'i fituar ato. Kolegët e mi patën mundësi të shpalosnin gjerësisht dështimet e kësaj qeverie në 8 vjetët e kaluar dhe unë, në këtë orë të mëngjesit, nuk dua të kaloj në përsëritje, por kam veçuar disa pika, të cilat tregojnë sa larg nga e vërteta dhe realiteti është ky dokument. Flasin për rindërtimin si një nga sukseset më të mëdha të kësaj qeverie. Unë duhet ta pranoj që ka qenë një nga sukseset më të mëdha të qeverisë, por jo për të ndërtuar dhe rindërtuar, siç është shitur, por si një nga operacionet më të suksesshme dhe efektive të blerjes së votës.

Sot, familjet në zonat e prekura nga tërmeti, që jetojnë në çadra, duhet ta dinë se nuk është punë lekësh pse po jetojnë aty, por çështje votash. Kur të kenë nevojë sërish për votën e tyre, do të shkojnë. Kështu kanë kaluar dy dimra, dhe me gjasë do të kalojë edhe i treti. Flasin për sukses në përballimin e pandemisë, ndërkohë që qytetarët e dinë fare mirë, sepse nuk morën asnjë qindarkë për të përballuar faturat e kripura të ilaçeve; mijëra biznese falimentuan dhe u mbyllën, mijëra qytetarë humbën vendet e punës dhe nuk morën asnjë ndihmë. Flitet për sukseset në arsim, por harrohet, me vetëdije, sigurisht, që në fshatrat dhe qytetet e vogla shqiptare u mbyllën qindra shkolla për shkak të braktisjes dhe si rezultat i emigracionit. Flitet për taksim të ndershëm të qytetarëve dhe bizneseve, por në të

vërtetë, në 8 vjetët e kësaj qeverie, një grusht njerëzisht kanë përfituar dhe janë bërë më të pasur me paratë e buxhetit, ndërkohë që qytetarët janë varfëruar shumë e më shumë. Mendoj se është cinike të flasësh për rritjen e madhe të pagave, sepse ka qenë rritja më e vogël në histori, për të mos folur për rritjen e çmimeve. Të përmendësh rritjen e pagave të infermierëve dhe mjekëve është ironike, ndërkohë që mjekët dhe infermierët po largohen drejt Gjermanisë. 78% e mjekëve shprehin dëshirën të largohen nga Shqipëria. Varfëria dhe papunësia e madhe kanë detyruar mbi gjysmë milion shqiptarë të largohen nga vendi në 8 vjet të kësaj qeverie. Nuk ka asnjë plan, asnjë fjalë për këta njerëz. Duhet pasur parasysh se Shqipëria, për numrin e azilkërkuesve, renditet njësoj me vendet: Siri, Irak apo Afganistan, vende trazirash dhe luftërash, dhe do të ishte e udhës të bëhej diçka për të. Sa krenar duhet të jesh për një sistem drejtësie të rilindur, kur Shqipëria përgjatë 3 vjetëve u bë vendi i vetëm në Europë e më gjerë, pa Gjykatë të Lartë dhe pa Gjykatë Kushtetuese? Sa të kënaqur mendon se duhet të jenë ata qytetarë, që presin gjykimin në Gjykatën e Lartë të mbi 31 mijë çështjeve të tyre, apo ata që presin në Gjykatën e Apelit të zgjidhen mbi 40 mijë dosje? Çfarë u tha sot për këta qytetarë, që duhet të presin mbi 10 vjet, të paktën, që problemet e tyre të marrin zgjidhje? I vetmi burim krenarie për Kryeministrin duhet të jetë përgjigjja e prokurorisë që asnjë ministër nuk është në hetim. Në fakt, duhet të jetë krenar, por edhe i qetë, besoj.

Flasin për integrimin e Shqipërisë në BE, por të gjithë e dimë se vendi ka mbetur në vend numëro prej vitesh. Flasin për sukses në politikën e jashtme, por kjo qeveri ka raportet më të këqija që ka pasur ndonjëherë një qeveri shqiptare me autoritetet shtetërore të Kosovës. Linjat zyrtare të dy qeverive përplasen qartazi me njëra-tjetrën, megjithëse një komb. Lista e dështimeve mund të vazhdonte pafundësisht dhe as ky fjalim, as kjo seancë, nuk do të ishin të mjaftueshme për t'i shpalosur të gjitha, por edhe nga këto sa u thanë, për çdo qytetar është e qartë se ky dokument nuk është gjë tjetër, veçse lista e radhës së premtimeve, të cilat, sigurisht, nuk do të realizohen. Për këtë arsye, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të votojë kundër kësaj qeverie dhe kundër këtij programi. Faleminderit!